



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 6 të Rregullës Nr 18/2016, për Emërimet Përbërjen Funkcionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 04.09.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Emërohen anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 06 tetor 2019, për komunat:

*Deçan, Gjakovë, Glllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Lipjan, Vushtrri, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani Elezit, Graçanicë, Ranilluk, Parteshë, Kllokot Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok.*

- II. Regjistri i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për komunat, si në pikën I të këtij vendimi, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Mandati i KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të mandatit ose zgjatet me vendim të veçantë të KQZ-së.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

Prishtinë, 04.09.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



**Valdete Daka**